Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/506
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.08.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Korrigjohet vendimi Nr.: 01/38 i datës 22.02.2022, me të cilin: Riakreditohet institucioni "Akademia e Kosovës për Siguri Publike - AKSP", me adresë: Rr: Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Vushtrri, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 24.07.2021 deri më 23.07.2024, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

2. Korrigjimi i vendimit 01/38 i datës 22.02.2022 bëhet tek pika 1.2, 1.5 dhe 1.6 dhe i njëjti formulohet/korrigjohet si në vijim:

2.1 1.2. Zjarrfikës, **Niveli IV** sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 80 kredi të AAP. Institucioni, për këtë profil riakreditohet për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 04.04.2022 deri më 03.04.2025. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me më së shumti dy (2) gjenerata brenda vitit, duke përfshirë 22 kandidatë për gjeneratën përkatëse. Fillimi i të dyja gjeneratave mund të bëhet brenda vitit, por jo në të njëjtën kohë,

2.2 1.5. Zyrtar Policor, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me **72 kredi** të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me më së shumti dy (2) gjenerata brenda vitit, në numrin e kandidatëve të përcaktuar maksimalisht 500 (pesëqind) kandidatë. Grupet brenda gjeneratës përkatëse duhet të ndahen nga koordinatorët e programeve dhe sipas nevojës, ashtu siç përcakton kurrikula përkatëse. Fillimi i të dyja gjeneratave mund të bëhet brenda vitit, por jo në të njëjtën kohë.

2.3 1.6. Zyrtar Sprovues, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me **34 kredi** të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit më së shumti dy (2) gjenerata brenda vitit, duke përfshirë 50 kandidatë për gjeneratën përkatëse. Fillimi i të dyja gjeneratave mund të bëhet brenda vitit, por jo në të njëjtën kohë.

3. Pjesa tjetër e vendimit 01/38 i datës 22.02.2022 mbetet e pandryshuar.

4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Akademia e Kosovës për Siguri Publike me datë 13.06.2023 ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot.: 01/357 me të cilën kërkon që të korrigjohet vendimi Nr. 01/38 i datës 22.02.2022 me të cilin vendim ishte vendosur për riakreditim dhe rivalidim të programeve të trajnimeve në këtë institucion. Kërkesa adreson gabimet teknike të cilat janë lëshuar në vendim dhe me qëllim të mos lëshohen certifikata dhe dokumente të tjera me këtë gabim kërkohet nga organi vendimmarrës Këshilli Drejtues i AKK-së që të bëhet korrigjimi i këtij vendimi.

AKK ka proceduar kërkesën për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KD të AKK-së të mbajtur me datë 03.08.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së pas shqyrtimit të kërkesës së AKSP-së me Nr.Prot.: 01/357, ka kërkuar që të verifikohen edhe njëherë raportet e ekspertëve mbi bazën dhe rekomandimet e të cilave KD kishte marr vendim.

Tutje KD ka verifikuar në detaje raportet dhe dokumentacionin nga ekipi i ekspertëve për kualifikimet përkatëse, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, të gjeturat në raportet e ekspertëve dhe kompetencat e tij ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi i dërgohet:

- Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar Këshilli Drejtues i AKK-së